



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:090961  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05680989

**A.C.nr.189/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Halide Reka, dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike jokontestimore të propozuesit S.S., i lindur D... nga Komuna Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson P.M., avokat me seli në Komuna Mitrovicë, për vërtetimin e vendit dhe datës së lindjes, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, departamenti i përgjithshëm, CN.nr.39/2020 datë 17.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e propozuesit S.S., i lindur D... nga Komuna Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, CN.nr.39/2020 datë 17.09.2020, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar CN.nr.39/2020 datë 17.09.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*“... Kjo gjykate shpallet inkompetente absolute qe te veproi sipas propozimit te propozuesit S.S., i lindur D... dhe propozimi te HUDHET...”*

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit, për shkak të gjitha shkaqet, me propozim Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa si e bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa e propozuesit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesi S.S., i lindur D... nga Komuna Mitrovicë, me datë 31.01.2022, ka parashtruar propozim për konstatimin e datës së lindjes, dhe vendin e lindjes.

Gjykata e shkallës së parë me datë 17.09.2020, ka marrë aktvendim CN.nr.39/2020 datë 17.09.2020, me të cilin ka vendosur që kjo gjykatë të shpallet inkompetente, dhe propozimi i propozuesit të hudhet, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e atakuar e ka arsyetuar ndër të tjera si vijon: *"...Nga arsyet e cekura me larte, Gjykata vendosi si ne dispozitiv te ketije aktvendimi, e ne kuptim te nenit 3 dhe 30 te Ligjit për Procedure Jokontestimore lidhur me nenin 18.1 dhe 18.2 dhe nenit 142.1 te LPK-se..."*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paropozuesit se aktvendimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se nga faktet e treguara në propozim, dhe duke u bazuar në të drejtën materiale, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është shpallë inkompetente, dhe e ka hudhë propozimin e propozuesit, bazuar në nenin 18.2 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t'i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale te kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur."*, bazuar në nenin 35 par.7 të Ligjit Nr. 04/L-003 për gjendjen civile në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Zyra e gjendjes civile, konstaton dhe konfirmon, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në paragrafin 2. të nenit 34 të këtij ligji."*, si dhe bazuar në nenin 54 të Ligjit nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Në rastet kur lindja apo vdekja nuk paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh atëherë regjistrimi bëhet me vendim të Zyrës së gjendjes civile."*

Janë vlerësuar pretendimet ankimore të propozuesit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.189/21 datë 14.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**